



PRANUAR MË:
ACCEPTED ON: 08/09/2022
PRIMLJENO:
Nr.No.Br. 0111567



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E MALISHEVËS

Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi

Zyra e Kryetarit
Nr. 01/
08.09.2022


PËR:	Të gjithë anëtarët e KKSB-së - Komuna e Malishevës
NGA:	z. Ekrem KASTRATI , Kryesues i KKSB-së - Komuna e Malishevës
LËNDA:	F T E S Ë për takimin e IV- të të KKSB-së -, 

Të nderuar !

Në bazë UA Nr: 27/2012 MPB – 03/2012 MAPL pë Këshillat Komunal për Siguri në Baskësi, përkatësishtë nenit 9, pika 1.3, f t o h e n i që të merrni pjesë në mbledhjen e IV-të, për vitin 2022, të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi.

Mbledhja do të mbahet ditën e Enjte me datë 15.09.2022, në sallën e Kuvendit të Komunës së Malishevës, duke filluar nga ora 09:30, me këtë rend të ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës, dhe proqesverbalit nga mbledhja e kaluar,
2. Siguria publike në Komunën e Malishevës;
3. Gjendja aktuale në arsim – përfundimi i vitit shkollor 2021/2022 dhe përgaditjet për fillimin vitit të ri shkollor 2022/2023, dhe
4. Të ndryeshme.



PRANUAR MË:
ACCEPTED ON: 08/09/2022
PRIMLJENO:
Nr.No.Br. 01/1562



REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA E MALISHEVËS

Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi

PROQESVERBALI

Komuna e Malishevës

Datë: 07.07.2022

Numri i takimit të KKSBB-së për vitin' 2022: III-të

Takim i regullt: PO

Numri i anëtarëve të KKSBB-së të pranishëm: 17

Pjesëmarrja e përfaqësuesëve të komuniteteve jo shumicë: PO

A kanë marrë pjesë anëtarë të tjera përveç anëtarëve të KKSBB-së: PO

- Në këtë takim kanë qenë prezent:
- Përfaqësuesit e KFOR-it-LMT zyra në Malishevë,
 - Përfaqësuesi i OSCE - Pëjë, dhe
 - ZKI-Malishevë.

Takimi është kryesuar nga: z. Vesel KRASNIQI, N.Kryetar i Komunës

Materiali për takimin e III-të të KKSBB-së është përcjell me kohë dhe sipas Udhëzimit Administrativ.

Takimi ka filluar në ora: 09:40

Rendi i ditës:

1. Miratimi i Rendit të ditës dhe Proqesverbalit,
2. Siguria publike në Komunën e Malishevës;
 - Përgaditjet për ardhjen e Dijasporës, etj.. dhe
3. Të ndryeshme.

➤ Tema shtesë:

Nuk ka

➤ Rendi i ditës dhe Proqesverbali : **m i r a t o h e t** unanimishtë me ndryshimin e pikës së dytë të rendit të ditës, nga Gjendja aktuale në Arsim-përfundimi i viti shkolar 2021/2022, në përgaditjen për pritjen e Dijasporës.

2. Siguria publike në Komunën e Malishevës;

Në kaudër të Sigurisë së përgjithshme publike në Komunën e Malishevës,

- ❖ Z. Vesel KRASNIQI; përgëzoj të gjithë akterët relevant për angazhimin dhe punën që po bojnë, që komuna e Malishevës të jetë ndër më qeta në nivel vendi.
- ❖ Z. Shqipron SHALA, Sektori i Emergjencave; informoj se Sektori i Emergjencave të komunës së Malishevës i ka marrë të gjitha masat e nevojshme për reagim, për sezonin veror, e në veçanti për zjarret, si dhe njoftoj për bashkëpunim me qytetarët për kujdes të shtuar, gjithashtu, shum shpejt do të fillon edhe spërkatja nga toka kundër EHKK, dhe se krahasuar me vitin e kaluar ka më paka raste të pickimit nga rriqërat (866 pickime), dhe se deri me tanë nuk ka raste të infektimit, kurëse, sa i përket gjendjes në QKMF në Malishevë, si pasoj e temperaturave të larta, vërehet fluks më i madh i pacientave, dhe apelon tek qytetarët që ti përfillin rekomandimet e mjekëvë për mos ekspozimin ndaj irrezeve të dijellit.
- ❖ Z. Vesel KRASNIQI; sa i përketë gjendjes me COVID-19, në komunën e Malishevës, për momentin është mirë e mangjueshme, dhe se aktive janë 16 raste.
- ❖ Z. Azem KRASNIQI; K-dant i stacionit policor në Malishevë, komuna e Malishevës, për sa i përketë sigurirë së përgjithshme publike, vazhdon të jetë një ndër komunat më të qeta në Republikën e Kosovës.
 - z. Krasniqi, më tej informoj se gjatë këtijë gjysëm viti, ka ramje e veprave penale me 42% në krahasim me periudhën e njëtë të vitit të kaluar, sa i përketë vjedhjeve, kurëse zbulueshmëria e tyre është rritur me mbi 77.7% gjatë këtijë 6 mujori, kurëse, sa i përket gjendjes në komunacion, vërehet një ngritje prej 34% të aksidenteve të ndodhura, kryesisht me dëme të vogla materiale, kjo rritje vjen edhe si pasoj e mungesës së sinjalistikës rrugore.
 - z. Krasniqi, informoj edhe për planet e hartuara operative për pritjen e

mergimëtarëve dhe të tjera që janë në realizim, e të cilat kanë për qëllim ngritjen e sigurisë së përgjithshme publike në komunën e Malishevës.

- ❖ Z.Amrush HELSHANI; kërkoi që të shqyrtohet mundësia e vendosjes së matësëve të shpejtësisë në qytet, si dhe intervenimi i i ispetoriatit , si dhe intervenimi i ispetoriatit në lokalet në të cilat është zërimi shum i lartë.
- ❖ Znj. Feride HOXHA; sëfundmi, shihet një siguri më e madhe në komunacion, por edhe mungesa e parkingjeve në qytet, si dhe shpreh shqetësimin e qarkullimit të lëndëve narkotike në qytet.
- ❖ Z . Azem KRASNIQI; sqaron se, sa i përketë shqetësimit të qarkullimit të lëndëve narkotike, nuk është edhe aq e rrezikshme dhe se është nën kontroll, si dhe mundësia e ndalimit të punës së lokaleve të Shisha Bareve, ndësa tek parkingjet, problem paraqesin e dhe vazot e vendosura para lokaleve nga pronarët, për qka nevojitet intervenimi i inspektoriatit.
- ❖ Z.Sead PAÇARIZI; BIK-Malishevë, shpreh gadishmerinë për të ndihmuara në mbajtjen e ligjeratavekundër dhunës.
- Pritja e mërgimëtarëve:
 - ❖ Z. Vesel KRASNIQI; mirëpresim ardhjen e mërgimëtarëve tanë nga diajspora, të cilët duhet ti presim në mënyrë vlazërore, për këtë edhe qeveria lokale ka ndërmarrë disa vendime për angazhime shtesë, dhe atë:
 - Lirimi i parkingjeve pë mërgimtarë (parkingu i Komunës së Malishevës),
 - Ofiqaria të punoj me arar të zgjatur,
 - Organizimi i festivaleve në Sheshin e qytetit,
 - Gadishmeria e Sherbimeve Emergjente (SHEM njësiti mobil), etj.
 - ❖ Z. Azem KRASNIQI; nga që presim një fluks të madhë të mërgimëtarëve tanë, presim edhe ngarkes në komunikacion, për këtë arsyen Stacioni Policor në Malishevë do të punoj me personel të shtuar për lëshimin e dokumentave.
 - ❖ Z.Sead PAÇARIZI; mirëpret ardhjen mërgimëtarëve, e në veçanti fëmijet e tyre, të cilët kanë mundësinë që të mos shkëputen nga njohja me kulturën e trevës së Malishevës dhe në përgjithësi të kombit Shqipëtar, si dhe kerkoi që të shqyrtohet mundësia që të ndalohet qarkullimi për automjete të rënda – kamiona nëpër qytet gjatë qendrimit të mërgimëtarëve, në mënyrë që të shkarkohet sado pak qarkullimi nëpër rrguget e qytetit.
 - ❖ Z.Amrush HELSHANI; mirëpret ardhjen mërgimëtarëve, janë të mirëseardhur sikurëse të ardhurat e tyre, si dhe kerkoi që festivalet që dotë organizohen, të

jenë të mirë informuar, duke botuar dhe shpërndarë fletushka, postera, etj, nëpër vendbanimet e komunës së Malishevës.

- ❖ Z. Azem KRASNIQI; kerkoi që të shiqohet baza ligjore për mbylljen e Shisha Bareve, kurëse sa i përket problematikës së trafikut, problematike paraqitet infrastruktura rrugore, posaçërishtë rrugët alternative.
z. Krasniqi. më tej theksoj se, me ardhjen e mërgimëtarvë, fillon edhe sezoni i dasmave, me ç'rast mund të ketë edhe përdorim të armëve, dhe se Policia e Kosovës nuk do të ketë tolenrancë, kurëse aksioni, Festo me Zemer e Jo me Armë do të vazhdoi edhe për këtë sezon.
- ❖ Z. Halit MAZREKU; koordinator i KKSBS, kerkoi që të bëhet botimi dhe vendosja e Fletushkave dhe Posterave vetëdijejsuese mbi përdorimin e Armëve, Narkotikëve, Zjarreve, EHKK, COVID-19 dhe regullave në komunacion
- ❖ Z. Vesel KRASNIQI; pasi që nuk paraqitet që dikush ta merr fjalën, e mbullim këtë pikë të rendit të ditës, dhe propozoj të nxjerrim edhe disa konkluzione dhe rekomandime, dhe kalojm në pikën tjetër të rendit të ditës.

3. Të ndyeshme.

NUK KA DISKUTIME

Konkluzion:

- KKSBS, vlerëson se, situate sigurisë së përgjithshme publike në komunën e Malishevës është stabile, e qetë dhe pa tendenca për destabizim, duke bërë që Malisheva të jetë njëra ndër komunat më të qeta në nivel vendi.


Rekomandim:

- KKSBS inkurajon të gjitha subjektet relevante të sigurisë së Komunës së Malishevës, që të bëjnë përpjekje dhe maksimalishtë angazhohen në ruajtjen e trendit të sigurisë së krijuar, dhe mërgimëtarët ti presim sa ma mire dhe të jemi në sherbim të tyre.
- Vendosja e matësëve të shpejtësisë së përpjekjeve rrugët e qytetit,
- Hartimi i projekteve për parkingje në qytet,
- Organizimi i prezantimeve artizanale,
- Organizimi i transportit për vizita të mërgimëtarëve nëpër pikat e trashegimisë kulturore etj,

Takimi përfundoi në ora:

10:50

Procesverbali u përpilua nga Koordinatori i KKSBS-së:



Halit Mazreku



Procesverbali aprovohet nga Kryesuesi i KKSBS-së:

Data e Aprovimit:

01.09.2022